



			
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
Qeveria Kosovës / Vlada Kosovo / Government of Kosovo			
Ministria e Financave dhe Transfereve / Ministarstvo za Finansije i Transfere			
Ministry of Finance and Transfers			
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosovo / Tax Administration of Kosovo			
ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. unit:	<u>Z. Q</u>	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	<u>12-06-841</u>
Nr. Faqëve Broj stranica No pages:	<u>1</u>	Data Datum Date:	<u>27.06.23</u>
01	HYRËSE	PRISHTINE/A	

PLANI KUNDËR KORRUPSION I ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Shkurt, 2023

HYRJE

Administrata Tatimore e Kosovës, si Agjencion Ekzekutiv me Autonomi të plotë operationale përbrenda Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, është përgjegjëse që të administrojë zbatueshmërinë e çdo lloji të tatimit të aplikuar me legjislacionin tatimor në Republikën e Kosovës. Misioni i ATK-së, është të mbledhë të hyra, të cilat mundësojnë financim në mënyrë të drejtë dhe transparente të shërbimeve publike. Ky plan parashikon ndërlidhjen me dokumente të tjera strategjike, angazhime ekzistuese ose të ardhshëm të ATK-së, në mënyrë që të parandalohet korrupsioni.

ATK ka kryer misionin e saj me sukses për 23 vjet, mision i cili mbështetet në këto Parime, të cilat do të jenë shtyllat e këtij plani:

- **Parimi i ligjshmërisë:** Veprimet e ndërmarra bazohen në dispozitat e parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare.
- **Parimi i besueshmërisë:** Të përpiqen të fitojnë besimin dhe respektin e komunitetit duke qenë konsultues dhe bashkëpunues, komunikimet tona do të jenë të forta dhe të besueshme dhe ne do të respektojmë këshillat e dhëna nga të tjerët. Rregullat dhe standardet tona do të bashkohen dhe zbatohen në mënyrë të drejtë.
- **Parimi i paanshmërisë:** Punonjësit e Administratës Tatimore janë të paanshëm, vetëmohues, të besueshëm dhe respektojnë parimet e etikës profesionale në bashkëpunim me tatimpaguesit. Ata kryejnë detyrat e tyre pa asnjë ndikim të pahijshëm.
- **Parimi i transparencës:** Aktivitetet tona do të jenë të justifikueshme dhe të hapura për një kontroll publik, me politika të qarta dhe të arritshme dhe një procedurë të drejtë dhe efikase të ankesave. Ne do të synojmë t'i mbajmë udhëzimet tona të publikuara, të thjeshta dhe miqësore për përdoruesit, për t'i ndihmuar tatimpaguesit të kuptojnë se çfarë pritet prej tyre dhe çfarë mund të parashikojnë në kthim.
- **Parimi i proporcionalitetit:** Aktivitetet tona do të jenë të bazuara në rrezikun e paraqitur, e që nënkupton ushtrimin e autoritetit vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që nevojitet për të arritur objektivat legjitime, me mjete dhe metoda të përshtatshme, kohë sa më të shkurtër të mundshme.

Për t'i respektuar këto parime, ATK-së i duhet një staf i pa korruptuar dhe staf me sjellje etike, e për t'u arritur ky synim ATK në vazhdimësi ka nxitë luftën kundër korrupsionit duke parandaluar dhe identifikuar raste të korrupsionit dhe duke ndëshkuar zyrtarët me sjellje jo të mira.

Me qëllim të ruajtjes së integritetit, ATK ka vendosur mekanizmat e saj për parandalim, identifikim, dhe sanksionim të zyrtarëve të korruptuar dhe me anë të dokumenteve strategjike ka nxitur parimet e lartshënuara të cilat janë shtyllat kryesore të Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes për Administratën Tatimore.

Plani Kundër Korrupsionit është përmbledhjeve e objektivave të rëndësishme që realizon Administrata Tatimore e Kosovës në luftimin e korrupsionit dhe përmban aktivitetet që synohen të realizohen gjatë vitit 2023.

Plani mbështetet në legjislacionin aktual dhe përfshinë objektivat e përgjithshme dhe objektivat specifike nga këto tri dokumente të aprovuara nga Drejtori i Ekzekutiv i ATK-së:

- Plani i Veprimit 2022-2024 për Zbatim të Strategjisë së ATK-së 2022-2026;
- Plani për Përmirësimin e Integritetit në Administratën Tatimore të Kosovës 2021-2023;
- Plani Operativ i Divizionit të Standardeve Profesionale (DSP) në Administratën Tatimore të Kosovës.

Me këtë plan synohet rritja e bashkëpunimit me institucione kompetente për luftimin e korrupsionit, rritja e llogaridhënës, rritja e transparencës, zvogëlimi i diskrecionit të zyrtarëve të ATK. Po ashtu, plani parasheh edhe masa edukuese për parandalimin e sjelljeve të këqija, parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe rritjen e bashkëpunimit me qytetarët dhe OJQ që parandalojnë korrupsionin. Gjithashtu, me këtë plan parashihet edhe zbulimi dhe hetimi i zyrtarëve që keqpërdorin pozitën zyrtare dhe inicimin e rasteve për trajtim në organet kompetente.

PLANI KUNDËR KORRUPSION I ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Nr.	Objektivat (Synimet)	Aktivitetet – Detyrat	Afatet	Departamenti përgjegjës dhe përkrahës	Produkti (Output)
1	Hetimi i rasteve të dyshimta lidhur me veprimet e zyrtarëve të ATK-së, si dhe trajtimi i informacioneve të dyshimta për stafin e ATK-së lidhure me keqpërdorimin e pozitës zyrtare.	<ul style="list-style-type: none"> - Verifikimi informacioneve/ankesave dhe analiza e tyre për përcaktimin e bazës për hetim; - Hetimi i rasteve administrative; - Përgatitja e raportit përfundimtar të rastit; - Dërgimi i lëndës në organe përkatëse (Drejtoritë, Policisë, Prokurorisë, etj.); - Inicimi i rasteve në organe kompetente. 	Në vazhdimësi	Divizioni i Standardeve Profesionale (DSP).	<ul style="list-style-type: none"> - Informacionet e trajtuara nga DSP dhe nr. i tyre; - Raportet e Rasteve të trajtuara dhe masat disiplinore të shqiptuara.
2	Monitorimi i Planit për Përmirësimin e Integritetit (PPI) në Administratën Tatimore të Kosovës 2021-2023.	<ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli i aktiviteteve të implementuara që lidhen me PPI; - Komunikimi me zyrtarët përgjegjës për implementimin e aktiviteteve; - Implementimi i aktiviteteve të PPI 2021-2023 që janë përgjegjësi e DSP; - Përcjellja e dinamikës së implementimit të Planit për vitin 2021-2023; - Përgatitja e raportit. 	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - Divizioni i Standardeve Profesionale (DSP) - Departamenti për Funksione të Pavarura, etj. 	Raportet e monitorimit për implementimin
3	Monitorimi i respektimit të rregullave që dalin nga Kodi i Mirësjelljes të nxjerr nga ATK.	<ul style="list-style-type: none"> - Inspektive pa paralajmërim dhe sipas kërkesave; - Bashkëpunimi me udhëheqësit; - Dhënia e këshillave lidhur me Kodin e Mirësjelljes; - Përgatitja e raportit/Inspektimit; 	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - Divizioni i Standardeve Profesionale - Mbikëqyrësit e Drejtpërdrejtë. 	Raportet Tremujore të DSP

		<ul style="list-style-type: none"> - Përcjellja e rezultateve të sondazheve lidhur me hulumtimin. 			
4	Edukimi i stafit lidhur me parandalimin e dukurive negative në ATK.	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e materialeve për trajnime; - Mbajtja e ligjëratave/trajnimeve për rregullat e sjelljeve në ATK; - Koordinimi i aktiviteteve tjera teknike me Divizionin për Trajnime dhe Zhvillim; - Shpërndarja e Kodit të Mirësjelljes sipas nevojës; - Shpërndarja dhe grumbullimi i formularëve për pajtim me Kodin e ri të Mirësjelljes; - Bashkëpunimi me udhëheqës; - Komunikimi me stafin për çështjen e pakove ligjore kundër korrupsionit, rregulloret e brendshme, etj. 	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - Divizioni i Standardeve Profesionale - Divizioni për Trajnime dhe Zhvillim në ATK. 	Raportet mbi numrin e zyrtarëve të trajnuar, Tremujore të DSP, dhe raportet mbi numrin e zyrtarëve të trajnuar nga institucionet tjera.
5	Menaxhimi i informacioneve për parregullsi tatimore.	<ul style="list-style-type: none"> - Hapja e kutive të vërejtjeve dhe dërgimi i informatave të zyrtarët kompetent; - Pranimi i informacioneve për evazion tatimor, parregullsi tatimore dhe rasteve për sjellje jo të mirë; - Dërgimi i informatave në departamentet kompetente; - Analizimi i raporteve kthyes nga departamentet kompetente dhe përgatitja e raporteve përmbledhëse; - Përgatitje e raportet nga aplikacioni për punësim; - Me ndihën e USAID, krijimi i një aplikacioni për raportim dhe menaxhim të rasteve të denoncuara. 	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - Divizioni i Standardeve Profesionale - Divizioni për Thirrje të Tatimpaguesve. 	<ul style="list-style-type: none"> - Aktivitet në teren për denoncimet e trajtuara, - Raportet Tremujore mbi rezultatet e denoncimeve.

6	<p>Analizimi dhe pranimi i deklaratave të gjendjes së pasurisë sipas Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarim Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Shpërndarja dhe grumbullimi i formularëve të deklaratave të gjendjes pasurore; - Pranimi formularëve; - Përpunimi dhe analizimi i tyre; - Dhënia e këshillave për punonjësit e ri. - Bashkëpunimi i APK lidhur me deklaratat e pasurisë nëpërmjet pikës së kontaktit; - Inicimi i kërkesave ligjore për deklarim të pasurisë; - Njoftimi i zyrtarëve për obligimet që kanë me ligjin e ri për deklarim të pasurisë, etj. 	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - Agjencia për Parandalim të Korrupsionit - Divizioni i Standardeve Profesionale. 	<ul style="list-style-type: none"> - Aktivitetet në teren me Agjencinë për Parandalim, - Deklarata e Pasurisë së deklaruar dhe rezultatet nga kontrolli i tyre.
7	<p>Rritja e llogaridhënës nëpërmjet mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunimi me mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë për trajtimin e rasteve; - Inicimi nga mbikëqyrësit dhe shqiptimi I masave disiplinore; - Monitorimi në lidhje me plotësimin e detyrimeve që kanë mbikëqyrësit ndaj stafit. 	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - Divizioni i Standardeve Profesionale - Mbikëqyrësit e drejtpërdrejt. 	<ul style="list-style-type: none"> - Takimet me mbikëqyrës, komunikimi i vazhdueshëm dhe masat disiplinore të shqiptuara
8	<p>Rritja e bashkëpunimit me institucione tjera në luftimin e korrupsionit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Këmbimi i informacioneve me Prokurorin ose me Policinë e Kosovës, lidhur me vepra penale; - Kërkesë për asistim nga Policia dhe Prokuroria për raste të rënda; - Marrja pjese në grupe punuese/takime; - Këmbimi i informacioneve dhe përvojave me institucione të tjera brenda; 	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - Divizioni i Standardeve Profesionale - Zyrtaret Përgjegjës - Institucionet kompetente. 	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i aktiviteteve të realizuara dhe numri i rasteve të adresuara në organe kompetente.

		<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunimi me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsion për këto aktivitete; - Bashkëpunimi dhe raportimi sipas përgjegjësive që ka zyrtari përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit; - Bashkëpunimi dhe raportimi sipas përgjegjësive që ka zyrtari përgjegjës për çështjen e pasurisë dhe dhuratave; - Bashkëpunimi dhe raportimi sipas përgjegjësive për mbrojtjen e sinjalizuesve. 			
9	Bashkëpunimi me OJQ dhe Palë tjera të interesit, me qëllim të luftimit të dukurive negative.	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja në seminare, takime, debate, trajnime, etj.; - Përgatitje raporteve dhe kthimi i përgjegjëseve sipas kërkesave ligjore. - Përcjellja e implementimit të MEMO me BIRN, etj ; 	Në vazhdimësi	Divizioni i Standardeve Profesionale.	Numri i aktiviteteve të realizuara
10	Rritja e sigurisë së integritetit për stafin e ATK.	<ul style="list-style-type: none"> - Kërkesa e dëshmisë së zyrtarëve për të ofruar dëshminë që nuk është i dënuar për ndonjë veprë penale; - Parashtrimi i kërkesës për sjelljen e vërtetimeve; - Pranimi dhe Verifikimi i tyre; - Analiza dhe veprime në lidhje me të gjeturat. 	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - Divizioni i Standardeve Profesionale - Divizioni i Burimeve Njerëzore. 	Numri i certifikatave të pranuar dhe analiza e tyre
11	Nxitja e Parandalimit të Konfliktit të Interesit.	<ul style="list-style-type: none"> - Kërkimi i deklaratave në lidhje me konfliktin e interesit; 			

		<ul style="list-style-type: none"> - Analiza e deklaratave; - Shqyrtimi i deklaratave; - Dhënia e opinioneve; - Pranimi dhe trajtimi i informacioneve për konflikt të interesit; - Bashkëpunimi me Agjencinë për Parandalim të Korrupsionit (APK); - Raportimi në APK. 	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - Divizioni i Standardeve Profesionale - Udhëheqësit e Drejtpërdrejt, - AKK. 	<ul style="list-style-type: none"> - Numri i aktiviteteve të realizuara; - Numri i rasteve të parandaluara dhe - Numri i zyrtarëve që kanë marrë leje për punë sekondare.
12	Rritja e promovimit të kanaleve të raportimeve (0800-80-800, aplikacionit, kutitë e vërejtjeve, etj.)	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e fletëpalosjeve; - Përgatitja spotëve; - Publikimi në ueb-faqe, - Publikimi në rrjete sociale. 	TM4/2023	<ul style="list-style-type: none"> - Divizion për marrëdhënie me Publikun - Divizioni i Standardeve Profesionale. 	Aktivitetet për linjat e promovuara.
13	Rritja e transparencës.	<ul style="list-style-type: none"> - Nxjerrja e katalogut të publikimit të informacioneve; - Publikimi i masave disiplinore dhe aktiviteteve kundër korrupsionit; - Publikimi i Vendimeve ; - Njoftimi i opinionit se si dhe ku mund t'i gjen informacionet publike. 	Në vazhdimësi	<ul style="list-style-type: none"> - Divizioni i Standardeve Profesionale - Divizion për marrëdhënie me Publikun. 	Numri i aktiviteteve të realizuara dhe numri i dokumenteve të publikuara.
14	Krijimi i akteve nënligjore për të nxitur mbrojtjen e integritetit në ATK.	<ul style="list-style-type: none"> - Rishikimi i Rregullores për Kodin e Etikës; - Rishikimi i Rregullores për Kodin e veshjes dhe paraqitjes së nëpunësve civil; - Dhënia e kontributit në hartimin e rregulloreve për disiplinë dhe rekrutim në ATK; - Bashkëpunimi me departamentet kompetente. 	TM3/2023	<ul style="list-style-type: none"> - Departamenti për çështje juridike, - Divizioni i Standardeve Profesionale. 	Rregulloret e aprovuara sipas Ligjit të ri për Administratën Tatimore dhe Ligjit për Zyrtar Publik